

SISTEMI FINANCIAR SHQIPTAR DHE ROLI I INSTITUCIONEVE TË NDËRMJETËSIMIT

BRENDA TIJ

*Sherif Bundo**
*Edlira Luçi***
*Gentiana Cane****

Në ambientet ekonomike shqiptare, por jo vetëm në to, tema e nivelit të zhvillimit të sistemit financiar dhe e rolit të tij në përsheptimin e zhvillimit ekonomik të vendit, është gjithnjë aktuale. Ekonomia jonë aktualisht përjeton rritme relativisht të larta rritjeje. Si ekonomi e re tregu, ajo është duke kaluar nga faza e lindjes në fazën e rritjes. Bashkë me karakteristikat dhe vështirësitë e fazës në të cilën ndodhet, ekonomia jonë mbart me vete edhe potenciale ende të pashfrytëzuara zhvillimi. Sistemi financiar është, pa as më të voglin dyshim, katalizatori apo më saktë, laboratoriu ku zhvillimet ekonomike marrin formën dhe trajtën e duhur. Nuk mund të tepruhet dhe të identifikohet ekonomia me sistemin financiar të një vendi. Por, nuk mund të neglizhohet dhe as të pakësohet roli i pazëvendësueshëm i sistemit financiar në zhvillimin dhe begatinë ekonomike të një ekonomie kombëtare. Në teorinë mbi shkencën e financave dhe mbi rolin e sistemit financiar, ka një postulat të rëndësishëm : Niveli i zhvillimit dhe i rolit të sistemit financiar mbi ekonominë përcakton fazën në të cilën ndodhet zhvillimi ekonomik në një vend. Kështu, në funksion të nivelit, të rolit dhe të ndikimit që luan sistemi financiar mbi ekonominë, dallohen tre faza të zhvillimit ekonomik. Faza e parë është faza empirike. Ajo karakterizohet nga institucione financiare dhe sistem financiar i pazhvilluar. Kjo fazë i përket ekonomisë natyrale, ritmeve të ulëta të rritjes dhe të zhvillimit. Faza empirike e zhvillimit ekonomik ka si tipar

gjithashtu kryesor, shpejtësinë e ulët të rrethxhimit të kapitaleve dhe të rentës. Sipas nobelistëve të rinj në fushën e financës, një ekonomi ndodhet në fazën empirike të zhvillimit të saj, kur sistemi financiar dhe bankar dominohen nga ekonomia e cashit. Faza e dytë është faza e ekonomisë së kredisë. Në këtë fazë rritet shumë roli i institucioneve të ndërmjetësimit financiar dhe të kredisë, kryesisht i bankave. Aktiviteti bankar përbën një drejtim të rëndësishëm të transfertës së burimeve dhe të fondeve. Me ndërmjetësinë e bankave sistemi financiar bëhet më aktiv. Subjektet suficitare në burime dhe fonde i transferojnë ato tek subjektet deficitare. Në këtë mënyrë përshpejtohet zhvillimi ekonomik, dhe bashkë me të, shtohet edhe pasuria kombëtare. Faza e tretë është faza e tregjeve financiare. Institucionet e ndërmjetësimit financiar perfeksionohen kaq shumë, sa përveç institucioneve të ndërmjetësimit të likuiditeteve, lindin edhe institucione të ndërmjetësimit të të drejtave financiare. Në fazën e tregjeve financiare, ekonomia operon me paranë e padukshme, me paranë elektronike, ndërsa titujt dhe kapitalet transferohen dhe investohen pa njohur kufij kombëtarë dhe kufij sasiorë apo kohorë. Në ekonominë e tregjeve financiare, sistemi financiar ka pamjen e një tërësie të pafundme lidhjesh, transaksionesh, marrëdhëniesh dhe këmbimesh në flukse financiare dhe në para, të operacioneve dhe të institucioneve të një vendi, të cilat formojnë një zinxhir të njëpasnjëshëm transaksionesh, spirale, të mbyllura dhe që vetëm të konceptuara si një e tërë i japin kuptim vetë sistemit financiar.

Pas këtij pozimi të shkurtër teorik, le të shpresojmë jolodhës dhe jo të bezdisshëm, fantazia e specialistëve të ekonomisë dhe të financave kërkon përgjigjen e pyetjeve: Në çfarë niveli zhvillimi ndodhet aktualisht sistemi ynë financiar? Sa ndihet roli i tij në shpejtimin e zhvillimit ekonomik të vendit? Si janë raportet e hallkave të ndryshme të sistemit financiar me njëra-tjetrën dhe sa të harmonizuara veprojnë ato në tërësinë e ekonomisë kombëtare? Më tej; në cilat drejtime sugjerohet të investohet për të përmirësuar sistemin tonë financiar, si dhe për ta modernizuar atë? Sa kohë do të na duhet që të kalojmë nga njëra fazë e zhvillimit ekonomik në fazën tjetër më të lartë? A është sistemi ynë financiar i përshtatshëm për të komunikuar normalisht me sistemin financiar të vendeve të tjera të Evropës dhe të botës? Fantazia e ekonomistëve dhe e financierëve mund të formulojë një seri pyetjesh të tilla, sa aktuale aq edhe interesante. Por, është përsëri

kjo logjikë dhe fantazi që na lejon të shkëputemi dhe të diferencojmë në këtë lumë problematik, segmentin e interesit dhe të objektit të referimit tonë.

Meqenëse në vijim do të përdorim shpesh termin sistem financiar, dhe meqenëse disa herë e kemi ndeshur të konfunduar termin sistem financiar me termin sistem bankar, le të na lejohet të saktësojmë se «sistemi financiar është tërësia e tregjeve financiare, tërësia e ndërmjetësve financiarë, tërësia e shërbimeve dhe e institucioneve financiare që bëjnë të mundur komunikimin e përhershëm dhe të njëhershëm, pa kufizim kohe, vëllimi dhe hapësire, të financave të familjeve me financat e bizneseve dhe me financat publike».

Është evidente që diskutimi mbi sistemin financiar dhe rolin e tij në zhvillimin ekonomik të vendit tonë, kap hapësira të mëdha. Është gjithashtu evidente, që prononcimi dhe deklarimi për përgjigjen e pyetjeve të mësipërme nuk është vetëm çështje e angazhimit të një numri të kufizuar specialistësh. Këto tema janë gjithnjë të hapura. Meqenëse çdo kontribut është i mirëpritur, ne po prezantojmë opinionet tona.

E gjykoam me interes që gjithë problematikën e trajtimit rreth temës së zgjedhur prej nesh mbi sistemin financiar në Shqipëri, ta rendisim të sistemuar në katër seksione kryesore.

1. NË ÇFARË FAZE NDODHET EKONOMIA SHQIPTARE DHE SISTEMI YNË FINANCIAR?

Është pyetje që shtrohet natyrshëm prej kujt do që njih sado pak ligjësitë e zhvillimit ekonomik dhe evolucionin e sistemit financiar. Forca magjike e financës dhe e sistemit financiar, në përshpejtimin e zhvillimit ekonomik dhe progresin e shoqërisë qëndron te misteret që mbart dhe që fsheh financa dhe paraja. Vetëm në financë, ka kuptim të vërtetë thënia se «uji ngjitet më lart se burim». Si ekonomi tregu, ekonomia shqiptare është ekonomi e re. Ajo kalon, gjithashtu, nëpër fazat e ciklit të jetës së saj. Në fillimet e veta, në fillimet e viteve '90, ekonomia e tregut dhe marrëdhëniet e tregut tek ne zunë fill në kushtet e mungesës totale të institucioneve të tregut. Në aspektin

financiar dhe monetar, mund të themi me bindje të plotë se raportet e ekonomisë me financat ishin mjaft të dobëta. Forca rregulluese e mekanizmave dhe institucioneve financiare ia kishte lënë vendin ekonomisë së cash-it. Mund të thuhet pa asnjë hezitim, se i pari institucion i tregut që u instalua në vendin tonë ishte tregu i mallrave. Siç duket, tregtia dhe aktiviteti tregtar janë sektorët që mund të ushtrohen në kushtet e mungesës së financimeve apo në kushtet e financimeve të kufizuara. Roli i bankave dhe institucioneve të tjera financiare dukshëm ishte mjaft i dobët. Në këto 15 vitet e para të tregut shqiptar, reduktimi i cash-it ka qenë një nga objektivat parësore të Bankës së Shqipërisë. Kjo do të thotë se kemi vite që jetojmë fazën empirike të zhvillimit ekonomik në ekonominë shqiptare. Kohët e fundit ndjehet një zgjerim i hapësirave të sistemit të kredisë. Nga tre burimet e mundshme të financimit të rritjes ekonomike, deri sot rezulton që nevojat e financimit të ekonomisë janë realizuar kryesisht nga burimet e brendshme të bizneseve dhe nga burime të tjera jashtë ekonomisë. Roli ndërmjetësues i bankave dhe i përdorimit të kredisë afatgjatë, megjithë prirjet në rritje, vlerësohet akoma minimal dhe nën nivelin e këtij treguesi në vendet në tranzicion. Pra, në këto 15 vitet e para të tregut, krediti bankar dhe tregu financiar kanë ofruar mundësi të kufizuara për financim dhe për rritje ekonomike. Mungesa e tregut financiar aktiv dhe e transaksioneve të kryera nëpërmjet tij është një fakt i pamohueshëm. Këto dukuri, pa qenë nevoja të citojmë statistika, tregojnë se aktualisht ekonomia shqiptare ndodhet në fillimet e fazës së dytë. Ajo është duke trokitur në ekonominë e kredisë, fazë në të cilën pritet të rritet akoma më shumë roli dhe aktiviteti i bankave tregtare. Raporti kredi/depozita, që luhetet nga 10 për qind në vitin 2001 në 18.8 për qind në vitin 2004, është treguesi më domethënës për këtë konkluzion.

Po kështu, konkludohet se edhe roli i kredisë tregtare, i kredisë që akordojnë ndërmarrjet në mënyrë të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën, është i kufizuar. Kur themi që ekonomia shqiptare ndodhet në fillimet e fazës së dytë, kjo do të thotë se ajo është e prirur të zgjerojë aktivitetin dhe rolin e bankave, por jo se sistemi dhe institucionet e kredisë kanë arritur pjekurinë dhe maturinë e tyre. Ndërkohë, roli i tregut financiar është i limituar vetëm në disa operacione të kufizuara të tregut monetar. Tregu i kapitaleve de fakto është inekzistent. Në këtë mënyrë, rritja e shpejtë, në këto 10-15 vite, e vlerës së tregut

të aktiveve të veçanta apo të vlerës së tregut të ndërmarrjeve, mbetet akoma një burim i pavlerësuar dhe praktikisht i pamundur të përfshihet, në përshpejtimin e qarkullimit ekonomik të vendit. Ka me dhjetra dhe dhjetra ndërmarrje, të blera, të investuara apo të privatizuara, ndërmarrje në proces të shpejtë rritjeje, me vlerë tregu të disafishuar, por që për shkak të mungesës së vlerësimit të saj në tregun e kapitaleve, kjo vlerë tregu mbetet e pashprehur. Ajo aktualisht përfaqësohet nga një shifër e minimizuar, e rregjistruar në kontabilitetin e ndërmarrjeve dhe në llogaritë e pronarit apo në rastin më të mirë, të një numri të kufizuar bashkëpronarësh.

2. SA DINAMIK ËSHTË TREGU FINANCIAR SHQIPTAR ?

Nuk do të ishte i plotë diskutimi dhe trajtimi, në qoftë se nuk do të linim hapësirat e nevojshme për të treguar progresin e sistemit financiar shqiptar në këto vite të ekonomisë së tregut. Përveç zgjerimit, reformimit dhe konsolidimit të sistemit bankar, për të cilat është folur dhe do të flitet akoma në këtë Konferencë, përveç liberalizmit dhe shtimit të numrit të operatorëve në sistemin e tregut të sigurimeve të pronës, të jetës dhe të shëndetit, janë hedhur hapa seriozë dhe me perspektivë edhe në instalimin dhe funksionimin e institucioneve të kursim-kredisë, janë instaluar mekanizma dhe politika përherë dhe më të qëndrueshme në fushën e tatimeve, taksave dhe tarifave në sistemin e financave publike, pa harruar shumëllojshmërinë dhe larminë në organizimin, funksionimin dhe drejtimin e financave të ndërmarrjeve. Duke qenë të ndërgjegjshëm se tek ne janë instaluar strukturat dhe janë ndërtuar themelet, mbi të cilat ne presim të ngremë infrastrukturën që modernizojnë sistemin financiar, në vijim do të shprehemi lidhur me dinamizmin e tregut financiar shqiptar.

Së pari, sistemi ynë financiar ofron pak alternativa investimi dhe përdorimi të kursimeve dhe akumulimeve monetare të subjekteve të ndryshme mikroekonomike. Një nga objektivat madhorë të sistemit financiar është që, nëpërmjet mekanizmave të tij, të bëjë të mundur kalimin e pushtetit financiar të kursimeve nga poli i familjeve drejt polit të sipërmarrjes, i cili nga ana e tij, për sa kohë përjeton fazat e rritjes, ka nevojë për fonde. Për të realizuar këtë, financa ka sajuar

dhe ka prodhuar përherë produkte nga më të larmishmet. Në thelb, produktet e shumta financiare të botës së sotme moderne kanë vetëm një synim: t'u ofrojnë familjeve, qytetarëve, buxheteve familjare, një numër të madh mundësish për të investuar. Ekonomia dhe sistemi ynë financiar janë akoma larg. Ata shihen si të varfër në këto përpjekje. Nga një studim i kryer para pak kohësh në vendin tonë lidhur me alternativat e të investuarit prej familjeve, rezultoi se gati 93 për qind e të intervistuarve, nuk shohin mundësi tjetër veç blerjes apo ndërtimit të një shtëpie, kur u mungon apo të një shtëpie të dytë, kur kanë një rezidencë kryesore. As emigrantët, as diaspora, as të punësuarit dhe as ndonjë kategori tjetër nuk sheh mënyrë më të mirë për të përdorur kursimet veç ndërtimit ose blerjes së një shtëpie. Çfarë bëjnë dhe duhet të bëjnë dyqanet dhe bizneset e vogla të karakterit familjar me kursimet e tyre? Po ndërmarrjet e vogla dhe shumë të vogla? Po ndërmarrjet e mesme dhe me numër të kufizuar punonjësish? Kjo tregon për varfëri dhe nivel të ulët të zhvillimit të sistemit financiar. Kjo tregon për mundësi të kufizuara investimi edhe për subjekte të tjera jashtë ekonomisë shqiptare. Kështu ka ndodhur edhe në Evropë, në vitet e para pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Sot, në Evropë, ka një kategori të konsiderueshme punonjësish që pëlqejnë të investojnë në kompanitë e vendeve të lindjes për shkak të normave të larta të kthimeve dhe rrezikut të zvogëluar. Sigurisht, që një mundësi të tillë e ofrojnë sistemet financiare të përparura të vendeve respektive. Të njëjtën gjë do të thoshim edhe për pamundësinë e investimeve në ekonomitë e vendeve të tjera të qytetarëve tanë. Për të mos u zgjatur do të përfundonim që një ndër handikapet e sistemit tonë financiar është fakti që akoma financat personale ndihen të paintegruara në sistemin financiar. Po kaq shqetësim paraqet edhe gjendja në polin tjetër, atë të sipërmarrjeve. Fondet dhe kapitalet e angazhuara nga njëra anë, sistemi financiar i transferon te nxitja e shtimit të kapitaleve teknike dhe të aktiveve ekonomike të sipërmarrjeve. Është mision i tij nxitja, përkrahja dhe mbështetja me fonde e projekteve të reja dhe e bizneseve të reja.

Së dyti, në organizimin dhe drejtimin e sipërmarrjeve ka një parim të rëndësishëm që shpreh në thelb ndërveprimin e pronës dhe të administrimit. Kjo e nënkupton ndërmarrjen si një përbërje pronësish nga pikëpamja pasurore dhe si një përbërje asetesh dhe aftësish

administruese nga pikëpamja funksionale. Me fjalë të tjera, sistemi ynë financiar ofron mundësi të kufizuara për krijimin, funksionimin, zhvillimin dhe progresin e vërtetë të shoqërive anonime. Shoqëritë anonime konsiderohen si gjeneratorë të vërtetë të zhvillimeve ekonomike dhe të franksionimit të pronës dhe të kapitalit. Që të nxiten këto lloj shoqëri është e domosdoshme të krijohen kushte për të tregtuar kapitalet. Kemi përshtypjen që numri i aksionerëve të mundshëm të gatshëm të bashkëinvestojnë në krijimin dhe financimin e sipërmarrjeve të mëdha, të reja dhe me kthim të pranueshëm, kur kjo drejtohet nga një shoqëri anonime, do të ishte i madh. As qytetarët, as ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe as subjektet publike nuk kanë praktikisht mundësi të përfitojnë nga bashkimi i fondeve apo nga fraksionimi i kapitaleve. Kjo mungesë e dobëson dinamizmin e tregut tonë financiar.

Së treti, disa segmente të sistemit tonë financiar kanë mungesë të theksuar besueshmërie. Tregu i sigurimeve në mënyrë të veçantë, akoma lë përshtypjen e një segmenti ende të pakonsoliduar në sistemin tonë financiar. Kemi të bëjmë me një ndërmjetësim financiar mbi bazën e tregtimit të rrezikut. Kompanitë e sigurimeve, sigurinë e kthimeve të tyre e kanë bazuar te diferenca e madhe e raportit prime-dëme. Çfarë rreziku mbajnë përsipër ato kur madhësia e dëmeve të paguara nuk kapërcen shifrën 30 për qind të primeve të arkëtuara? Kjo ndodh nga që nuk ndodhin dëme? Kjo ndodh nga që dëmet që ndodhin në Shqipëri nuk kanë vlerë të lartë tregu? Kjo ndodh nga që kompanitë e sigurimeve që veprojnë në vendin tonë kanë nivel të lartë të shpenzimeve administrative dhe shkallë të lartë operative? Mendojmë se nuk vepron asnjë nga faktorët e sipërcituar. Ajo që ndodh tek ne në tregun e sigurimeve është e lidhur me ngurtësinë dhe paaftësinë në rregullimin e tregut. Deri më sot, në tregun e sigurimeve kemi më tepër transferim të fondeve, por jo të rreziqeve. Në fakt, misioni i tyre është transferimi i rreziqeve. Të qenit i siguar nuk është bërë akoma pjesë e mënyrës së jetesës dhe domosdoshmëri e organizimit të biznesit. Ka vend që kompanitë e sigurimeve dhe tregu i sigurimeve të orientohen drejt sigurimit vullnetar më tepër se sigurimet dhe primet e detyrueshme.

Pavarësisht progresit dhe përmbysjes së praktikave dhe mendësive të vjetra, në fushën e marrëdhënieve financiare të biznesit me

shtetin, hasim shpesh devijime dhe voluntarizëm. Në disa sektorë të financave publike mbizotërojnë metodat administrative në vend të logjikës ekonomike dhe të koncepteve të tregut. Ky shqetësim bëhet më i vlerësuar kur konsideron faktin që një pjesë e mirë e administratës fiskale zhvillohet dhe aftësohet më ngadalë se sektori privat. Nuk mjafton për shembull, fakti që ka një ligj shumë të mirë për tatimin mbi fitimin apo që tarifa e tatimit mbi fitimin pësoi një ulje të mëtejshme. Nga pikëpamja juridike dhe e politikave ekonomike kjo shënon një progres në një element të sistemit financiar, në segmentin e financave publike. Ky progres shndërrohet në një pengesë dhe handikap serioz, kur vëllimi i fitimit dhe i tatimit mbi fitimin nuk llogariten dhe nuk vlerësohen drejt, dhe për më tepër kur vlerësimi i tyre bëhet nga nivele të dobëta administrative. Edhe kjo është e lidhur me besueshmërinë e tregut financiar.

Së katërti, një nga funksionet më të rëndësishme të sistemit financiar është të sigurojë në kohën e duhur dhe me transparencën më të plotë informacionet e nevojshme mbi çmimet dhe mbi koston e kapitaleve në ekonomi. Me përjashtim të bankave, të cilat ofrojnë informacionin e nevojshëm publik, të siguruar dhe për të gjithë, mbi normat e interesave të kredive, përqindjen e interesave të depozitave dhe të bonove apo mbi kurset e këmbimit, në segmentet e tjera të ekonomisë, sistemi financiar nuk është përherë i gatshëm të ndihmojë vendimmarrësit për vendimmarrje të decentralizuara dhe në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Sa shumë kanë ndryshuar çmimet e shitjes së banesave në tre vitet e fundit! Sa pak i informuar është publiku lidhur me këtë. Kur themi kështu, nuk kemi aspak parasysh domosdoshmërinë e funksionimit të njëjësive dhe të agjencive shtetërore të informimit. Bëhet fjalë për informacionin që jep dhe duhet të japë vetë tregu, nëpërmjet sistemit financiar. Megjithë ndryshimet në mendësi, në modelet dhe në praktikat kontabël, megjithë ndryshimet dhe progresin në sistemet e vlerësimit dhe të legjislacionit mbi kontabilitetin, gjykojmë që përsëri informacioni kontabël mbi pasurinë, aktivitetin, rentabilitetin, detyrimet ndaj buxhetit të shtetit dhe mbi transaksionet e tjera financiare në ndërmarrje, është shumë larg kërkesave të kohës. Ky nivel i shërbimit të informacionit kontabël e bën inefficient veprimtarinë dhe rolin e gjithë sistemit financiar. Sa më komplekse të jetë ekonomia, aq më i rëndësishëm është roli i sistemit financiar në të. Ka një armatë

jashtëzakonisht të madhe specialistësh të fushës së financave, bankave dhe të kontabilitetit, e cila nuk mund të anashkalohet pa u integruar në kërkesat për rritjen e rolit të të gjithë sistemit.

3. RRIJTJA EKONOMIKE DHE BURIMET E FINANCIMIT TË SAJ TEK NE

Rritja është një prej parametrave më thelbësorë që shpreh përmbajtjen e zhvillimeve ekonomike të një ekonomie kombëtare dhe harmonizimin e tyre me elementet e tjera të zhvillimeve sociale. Ka disa vite që ekonomia jonë kombëtare përjeton ritme relativisht të larta rritjeje. Në 9 vitet e fundit, sipas INSTAT-it dhe Bankës së Shqipërisë, ato janë luhatur nga 4,7 për qind në rastin më të keq që i referohet vitit 2002, në 12.7 për qind që i referohet vitit që përfaqëson skenarin më të mirë, atij 1998. Rritje përafërsisht të njëjtë ka pasur ekonomia e vendit edhe 2-3 vite të tjera para këtij 9-vjeçari, të referuar prej nesh, në këtë kumtesë. Në këto shifra bën përjashtim viti 1997, përgjatë të cilit ekonomia kombëtare pësoi një rënie në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) prej 10,3 për qind.

Rritja ekonomike është produkt i shtimit të kapaciteteve prodhuese, i rritjes së rendimentit të punës në ekonominë tonë, i rritjes së nivelit teknologjik, i përfshirjes së kapaciteteve apo burimeve të reja në aktivitetin ekonomik, i përmirësimit të komunikimit ekonomik me ekonominë e vendeve të tjera të rajonit apo me gjerë etj., i disa prej këtyre faktorëve apo i të gjithëve njëherësh, të marrë së bashku.

Rritja ekonomike përbën një seri të vlerësueshme mjetesesh. Në bilancin e ekonomisë kombëtare, ajo përfaqëson shtesë të imagjinuar të aseteve, të cilat, në kuptimin ekonomik dhe financiar kanë gjithashtu burimet e veta të financimit. Me analizën e rritjes ekonomike dhe të ritmeve të saj, me analizën e rritjes në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe në dinamikë, në vite të ndryshme, janë marrë edhe studiuat e tjerë. Madje institucionet e shërbimit statistikor e kanë vënë përherë në fokusin e tyre komentin mbi rritjen dhe perspektivat e saj. Banka e Shqipërisë gjithnjë trajton raportet e rritjes ekonomike me normat vjetore të inflacionit dhe me parametrat e tjerë makroekonomikë dhe monetarë.

Në vijim, ne dëshirojmë të shprehim opinionin tonë lidhur me një këndvështrim të ri të rritjes ekonomike: me faktin se si financohet rritja ekonomike. Cilat janë burimet financiare të financimit të rritjes ekonomike tek ne? Burimet financiare të brendshme apo të jashtme të financimit të rritjes luajnë rol nxitës dhe përshpejtues apo ato vetëm shoqërojnë zhvillimet ekonomike në subjektet mikroekonomike?

Fillimisht mund të analizojmë strukturën e prodhimit të brendshëm bruto vendas për tre vitet e fundit 2001-2003, dinamikën e ndryshimit të tij dhe të sistemojmë në vijim disa opinione dhe konsiderata, të lidhura ngushtë me burimet financiare që mbështesin këtë ndryshim dhe rritje ekonomike.

Tabelë 1: Struktura e prodhimit të brendshëm bruto në ekonominë shqiptare, në përqindje.

No	Sektorët e ekonomisë	2001	2002	2003
1	Bujqësia	26.0	25.4	24.7
2	Industria	10.8	10.5	10.2
3	Ndërtimi	8.3	8.6	9.1
4	Shërbimi	45.7	45.9	46.1
5	Transporti	9.1	9.6	10.0
	Totali	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti vjetor, 2003. Ministria e Financave.

Nisur nga të dhënat e kësaj table dëshirojmë të ndalemi në disa momente të rëndësishme, të cilat do të ndihmojnë në analizën vijuese.

Së pari, peshën më të madhe specifike, pra kontributin më të madh në Prodhimin e Brendshëm Bruto të ekonomisë e jep sektori i shërbimeve, në të cilin sipas Bankës së Shqipërisë, janë përfshirë aktivitetet në sektorin e tregtisë, hotelerisë, restoranterisë dhe të shërbimeve të tjera. Indeksi i shitjeve për këtë sektor vitin e fundit (që i jemi referuar ne, pra viti 2003) është rritur 11.5 për qind, çka do të thotë se ky sektor që zë peshën specifike më të madhe në PBB, jep njëkohësisht, afërsisht edhe kontributin më të madh në rritjen ekonomike vjetore të ekonomisë kombëtare. Rritja ekonomike në këtë sektor të rëndësishëm rezulton të jetë financuar nga burimet e veta të subjekteve private, që ushtrojnë aktivitet në sektorin e shërbimeve dhe nga kredia bankare. Nga një analizë e hollësishme

e përdorimit të kredisë bankare sipas viteve dhe sipas sektorëve të ekonomisë rezulton që kredia e akorduar nga sistemi bankar në sektorët e shërbimeve ka tendencë të ulët. Teprica e kredisë prezanton shumën e kredisë, përdorur si burim afatgjatë kreditimi për sektorët e shërbimeve. Rritja e tepricës së kredisë prezanton financimin e rritjes ekonomike të këtyre sektorëve. Teprica e kredisë në fund të tre viteve të fundit, në sektorët që përbëjnë nënzërin shërbime paraqitet si më poshtë:

Tabelë 2: Teprica e kredisë në fund të vitit, shprehur në përqindje ndaj totalit të kredisë për ekonominë.

No	Degët e ekonomisë Klasifikuar në nënzërin shërbime	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004
1	Tregti, riparime automjete, artikuj shtëpiakë	41.3	40.4	34	23.3
2	Hotele dhe restorante	4.3	6	6	8.3
3	Transporti dhe telekomunikacioni	4.6	2.4	1	2

Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti vjetor, 2003. Ministria e Financave.

Krahasimi i shifrave të mësipërme tregon qartë prirjen se rritja ekonomike në sektorët e shërbimeve nuk është bazuar te rritja e financimeve me kredi, por te burime të tjera financiare. Meqenëse në vendin tonë, tregjet financiare nuk ekzistojnë ose nuk kanë performancën e duhur, edhe nëse formalisht kemi një Bursë, për rrjedhojë tregu financiar nuk merr pjesë realisht në financimin e rritjes ekonomike në sektorët e shërbimeve, mbetet të pranohet që rritja ekonomike në sektorët e shërbimeve të jetë realizuar nga burimet e brendshme të sektorit ose ndryshe nga kapacitetet vetëfinancuese të sektorit. Me fjalë të tjera mund të themi se rritja ekonomike, në njërin prej sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë, nuk ka nxitës dhe mbështetës të jashtëm financiarë. E njëjta pamje paraqitet edhe për transportin, që së bashku me sektorin e shërbimeve, japin mbi 50 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Këta sektorë, me këtë pozicion dhe mbështetje financiare që kanë ose do të vazhdojnë të zhvillohen me ritme relativisht të ulëta, ose në rastin më optimist do të vazhdojnë të qëndrojnë në të njëjtin nivel që kanë arritur.

Së dyti, sektorët e tjerë me peshë specifike të rëndësishme në prodhimin e brendshëm bruto të ekonomisë sonë kombëtare janë bujqësia, industria përpunuese, ndërtimi dhe ndonjë sektor tjetër.

Ritmet e rritjes ekonomike në bujqësi, ndonëse vlerësohen si të pranueshme, janë më të ulëta se rritja ekonomike në tërësi, çka ndikon në uljen e peshës specifike të sektorit në fjalë në prodhimin e përgjithshëm. Po kështu ndodh edhe me industrinë, kryesisht atë përpunuese dhe ushqimore, e cila në statistikat referuese është e ndarë nga bujqësia, ndërkohë që, sektori i ndërtimit përjeton prirje të kundërt, rritje të peshës së tij specifike në prodhimin e brendshëm bruto të ekonomisë kombëtare.

Financimi i rritjes së këtyre tre sektorëve, gjithashtu të rëndësishëm, të marrë së bashku vetëm për efekte studimore, rezulton gjithashtu të mos jetë realizuar nga sistemi i kredisë. Për këtë pohim do të na duhet të ndjekim në vijim tabelën me të dhënat respektive:

Tabela 3: Teprica e kredisë në fund të vitit në disa sektorë, shprehur në përqindje ndaj totalit të kredisë për ekonominë.

Nr	Degët e ekonomisë Klasifikuar në nënzërin shërbime	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003
1	Bujqësi, gjueti, silvikulturë	1.0	0.8	1.0
2	Industria përpunuese	19.5	17.0	16.0
3	Ndërtimi	12.5	8.6	10.0

Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti vjetor, 2003. Ministria e Financave.

Na duhet të pranojmë që ose ritmet e kreditimit të këtyre sektorëve të ekonomisë nuk kanë ndryshuar, ose ritmet e kreditimit kanë rënë, ose kreditimi është shumë më i ulët krahasuar me vetë rritjen ekonomike të sektorëve. Siç duket, financimi i rritjes ekonomike në këta sektorë është bërë nga faktorë të jashtëm, nga burime financiare jashtë sistemit tonë financiar. Më i pranueshëm dhe më i përdorshëm mendohet të ketë qenë financimi nga qarkullimi i pakontrolluar i fondeve për shkak të ekonomisë informale dhe parave të papastra, si dhe nga dërgesat valutore të emigrantëve. Megjithëse do të flasim në vijim, efekti i dy burimeve të sipërcituara duket ka qenë shumë i ndjeshëm, veçanërisht në sektorin e ndërtimit.

Së treti, ndryshe nga sa kemi konkluduar më sipër, përdorimi i kredisë bankare për të financuar ekonominë në fakt ka ardhur në rritje në shuma absolute dhe në parametra relativë. Këtë e shpreh edhe rritja e raportit të brishtë kredi/depozitë ndër vite. Këtu ka një situatë kontradiktore. Kjo vjen nga që sistemi bankar ka rritur kreditimin

ndaj ekonomisë në disa sektorë dhe aktivitete që nuk ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike, por ndikojnë indirekt në rritjen ekonomike ose përshejtojnë qarkullimin ekonomik të produktit të krijuar vitet e mëparshme. Kredia e akorduar nga sistemi monetar për pasuritë e paluajtshme pothuajse është trefishuar në 6 vitet e fundit. Ritme po kaq të larta rritjeje ka pasur edhe kredia për shërbimet e ashtuquajtura kolektive ose shërbimet sociale apo personale. Rritje të kreditimit të ekonomisë ka edhe në zëra të tjerë, që në fakt nuk kanë adresë të drejtpërdrejtë.

Lidhja e përdorimit të kredisë me rritjen ekonomike është në fakt më e gjerë. Ne shqyrtoam vetëm rritjen ekonomike në sektorët kryesorë të ekonomisë së vendit dhe rritjen e përdorimit të kredisë si një nga burimet kryesore të financimit të saj.

4. A ËSHTË I HARMONIZUAR DREJTIMI I LËVIZJES DHE I PRIORITETEVE TË SISTEMIT FINANCIAR ME DREJTIMIN E LËVIZJES DHE STRATEGJITË E ZHVILLIMIT TË EKONOMISË SHQIPTARE?

Në strategjitë e zhvillimit ekonomik të vendit tonë, qoftë ato sektoriale apo edhe në strategjitë me karakter më të përgjithshëm, sikurse është edhe strategjia për zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e varfërisë, në mënyrë të sintetizuar mund të themi se dukshëm janë evidentuar sektorët parësorë të ekonomisë. Kështu, përveç mbështetjes së shtetit për sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, zhvillimi i bujqësisë dhe industrisë agroushqimore, zhvillimi i turizmit dhe i ndërtimit, përbëjnë sektorët e evidentuar natyrshëm si parësorë në ekonominë tonë. Kjo përparësi është e mbështetur në shumë faktorë thelbësorë si burimet natyrore dhe pozita gjeografike, pasuria kulturore dhe tradita, burimet humane dhe pozita strategjike. Një pjesë e mirë e këtyre strategjive janë të miratuara në forume shkencore përfshi dhe Qeverinë Shqiptare. Kjo do të thotë se shteti dhe ekonomia jonë e kanë përcaktuar rrugën e përparësive të zhvillimit. Kjo do të thotë akoma se këta sektorë të evidentuar si parësorë, do të jenë në qendër të zhvillimeve të kontrolluara dhe të politikave orientuese dhe nxitëse. Ndërkohë mbetet të diskutojmë

se a ka edhe sistemi financiar shqiptar të njëjtat përparësi? A janë pra të harmonizuara drejtimit e lëvizjes së përparësive të sektorëve ekonomikë me drejtimit e lëvizjes së sistemit financiar? Nëse po, kjo do të ishte prova e një zhvillimi dhe progresi të mbarë. Nëse jo, lipset të bëjmë rregullimet e nevojshme. Ky është një problem i rëndësishëm. Zbulimet e mëdha në financë dhe rritja e rolit të saj, janë në konflikt me përqendrimet e mëdha të autoritetit në nivele qendrore. Këtë ekuacion ekonomik nuk mund ta zgjidhë as dora e padukshme dhe as dora e kontrollit shtetëror. Kemi përshtypjen se sistemi financiar në përgjithësi, por edhe ai bankar në veçanti kanë qëndruar pak larg bujqësisë. Te bujqësia dhe te prodhimet me origjinë bujqësore dhe blegtorale sistemi ynë financiar nuk po gjen dot forcën e vet tërheqëse. Ndërkohë, përdorimi pa kriter i tokës bujqësore dhe zënia e saj me çfarëdolloj ndërtime, po kthehet në një fenomen tepër shqetësues. Ruajtja dhe mirëpërdorimi i tokës së kufizuar bujqësore, si dhe indiferenca e mekanizmave financiarë në inkurajimin dhe nxitjen e përdorimit dhe të shfrytëzimit të saj, përbëjnë një mungesë të dukshme të harmonizimit të drejtimit të lëvizjes së strategjive të prodhimit dhe degëve të ekonomisë, me drejtimin e lëvizjes së sistemit financiar.

Sistemi financiar i ekonomisë sonë, megjithëse pranojmë se nuk është shumë modern dhe i zhvilluar, është gjithsesi mjaft kompleks. Ai kërkon investim të harmonizuar dhe në shumë drejtime njëherësh. Disa hallka të sistemit financiar, sikurse janë bankat dhe sistemi bankar, duket që po përparojnë më shpejt. Është e dobishme të kuptojmë se sa më shumë segmente të konsoliduara të ketë në përbërje të vet sistemi ynë financiar, aq dhe më e qëndrueshme do të jetë vetë ekonomia.

LITERATURË

1. *Bodie Zvi (Nobelist), Merton Robert, Finance, (2002), parathënie nga Paul Samuelson, Nobelist.*
2. *Goffin Robert, Principes de Finance Moderne, 3 e edition, (2001)*
3. *Libri i Ligjeve dhe Rregulloreve të Bankës së Shqipërisë, Vëllimi i pare.*
4. *Bundo Sherif, Kursimi dhe sistemi financiar e bankar në ekonominë shqiptare, në librin: "Zhvillimi ekonomik-shoqëror i trojeve shqiptare dhe integrimi i tyre rajonal dhe botëror" (2000).*
5. *Bundo Sherif, Luçi Edlira, Për një paketë politikash që inkurajojnë prodhimin vendas, në librin "Prodhimi vendas-Energjia e Progresit" (2002).*
6. *Luçi Erjon, "Financial intremediation in teransition economies, With special referance to Albania", A thesis for the degree of Doctor of Phyllosophy, Stafffordshire University, 2002.*
7. *J. Schumpeter, theorie de l'evolution economique, Paris, 1985.*
8. *Bienayme A,...La croissance de l'entreprise, Paris 1973.*
9. *Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor, 2001*
10. *Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor, 2002*
11. *Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor, 2003*
12. *Instituti i Statistikave, INSTAT, Raporti Vjetor 2001.*
13. *Instituti i Statistikave, INSTAT, Raporti Vjetor 2002.*
14. *Instituti i Statistikave, INSTAT, Raporti Vjetor 2003.*

SHËNIME

* Sherif BUNDO: Profesor, Në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.

** Edlira LUÇI: Pedagoge, Në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.

*** Gentiana CANE: Pedagoge, Në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.